



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:020086

Datë: 17.05.2022

Numri i dokumentit: 03081774

PPP.nr.101/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, me seli Prishtinë, Rruga “Bill Klinton” p.n, kundër debitorit J. P. nga F. K., Rruga “...”, ..., lidhur me çështjen përmbarimore për borxh, në vlerë prej 237.30 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.514/2019 të datës 18.06.2019, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Eset Murati në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit J. P. nga F. K., Rruga “...”, ..., **SHFUQIZOHET** Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.514/2019 i datës 18.06.2019, lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Eset Murati në Prishtinë në shumë prej 162.10 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës për periudhën kohore nga data 01.01.2009 e deri me datë 31.12.2017.

II. REFUZOHET pjesërisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit J. P. nga F. K., Rruga “...”, ..., në shumën prej 75.20 euro, dhe në këtë vlerë, Urdhri Përmbarimor P.nr.514/2019 i datës 18.06.2019, për periudhën kohore 01.01.2018 deri me datë 30.04.2019, **MBETET NË FUQI**.

A r s y e t i m

Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Eset Murati në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit të verifikuar nga librat afaristë të kontabilitetit me ID nr.49746, për shërbimet komunale-bartja e mbeturinave për periudhën kohore 01.01.2009 e deri

me 30.04.2019, në shumë prej 237.30 euro, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh duke filluar nga dita e pranimit të urdhrit, e deri në pagesën definitive t'i paguajë kreditorit borxhin me kamatë ligjore nga dita e caktimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së përmbartuesve privat.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit dhe se debitori njëkohësisht nuk ka qenë as shfrytëzuese banesës në kohën kontestuese. Me tej i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhri për Përmbartim.

Kreditori brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, sipas prapësimit të debitorit, ka vlerësuar afatet e parashkrimit të kërkesës së kreditorit dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrimin e pjesërishtë të kërkesës së kreditorit dhe atë në shumë prej 162.10 euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2009, e deri me datë 31.12.2017 dhe atë në kuptim të nenit 360 par.1 dhe 360 par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, pasi që për këtë pjesë të borxhit, afati i parashkrimit ka arritur më së voni deri më 31.12.2017, ndërsa propozimi për përmbartim është paraqitur me datë 18.06.2019.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, duke lënë në fuqi Urdhrit Përmbartimor P.nr.514/2019 të datës 18.06.2019, në shumën prej 75.20 euro, pasi që borxhi në fjalë është krijuar nga data 01.01.2018 e deri më 30.04.2019, ndërsa propozimi për përmbartim është paraqitur me datë 18.06.2019, Gjykata vlerësoi se nuk kaluar afati një (1) vjeçar i parashkrimit në kuptim të Nenit 360 par.3 të LMD-së, pasi që afati një (1) vjeçar i parashkrimit për borxhin e vitit 2018 ka filluar të rrjedhë nga data 01.01.2019.

Gjykata, analizoi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe në pajtim me nenin 73 par. 2 dhe 3 të LPP-së, e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit lidhur me pjesën e kërkesës e cila është parashkruar, ndërsa e ka refuzuar prapësimin pjesërisht për pjesën tjetër.

Gjykata nuk ja ka falur besimin pretendimeve të debitorit se e njëjta gjatë periudhës kontestuese nuk ka jetuar në banesë ngase me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ndonjëherë ka paraqitur ndonjë kërkesë të kreditorit lidhur me faturimin e vazhdueshëm nga kreditori. Ndërsa faturat e rrymës të

bashkangjitura në prapësim nga të cilat shihet se nuk ka shpenzime të energjisë elektrike për gjykatën kjo provë e paraqitur është irelevante në këtë çështje juridike përmbare, për t'ia falur besimin se e njëjta nuk i ka shfrytëzuar shërbimet e kreditorit në këtë rast.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

G JYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PPP.nr.101/2021 datë 17.05.2022

Gjyqtari,
Adnan Konushevc

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.